



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
**GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS RAHOVEC**

---

Numri i lëndës: 2021:175429  
Datë: 03.06.2024  
Numri i dokumentit: 05771950

PPP.nr.105/2021

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË – DEGA NË RAHOVEC, gjyqtari Betim Behluli, me bashkëpunëtoren profesionale Adelina Çmega, në çështjen juridike të përmbarimit, sipas propozimit për përmbarim të kreditorit Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale, me seli në kundër debitorit të përmbarimit S.Th nga fshati Kramovik, Komuna e Rahovecit, lidhur me përmbarimin e dokumenteve përmbaruese aktvendimit të Komisionin të Pavarur për Miniera dhe Minerale, Nr.2718, i datës 04.10.2012, i formës së prerë nga data 23.04.2021, i ekzekutueshme nga data 09.05.2021, dhe aktvendimit të Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale, Nr.2719, i datës 04.10.2012, i formës së prerë nga data 23.04.2021, i ekzekutueshme nga data 09.05.2021, të lejuar me urdhrin për përmbarim P.nr.212/21, i datës 24.05.2021, të përmbaruesit privat I.I.K në Prishtinë, duke vendosur sipas prapësimit të debitorit të përmbarimit, më datë 03.06.2024, morri këtë:

**A K T V E N D I M**

I. REFUZOHET i pabazuar prapësimi i debitorit të përmbarimit S.Th, ushtruar kundër urdhrin për përmbarim, P.nr.212/21, i datës 24.05.2021 të përmbaruesit privat, I.I.K në Prishtinë.

II. MBETET NË FUQI urdhri i përmbaruesit privat I.I.K në Prishtinë P.nr.212/21, i datës 24.05.2021, me të cilin është caktuar përmbarimi në bazë të dokumentit përmbarimor aktvendimit të Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale, Nr.2718, i datës 04.10.2012, i formës së prerë nga data 23.04.2021, i ekzekutueshëm nga data 09.05.2021 dhe aktvendimit të Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale, Nr.2719, i datës 04.10.2012, i formës së prerë nga data 23.04.2021, i ekzekutueshëm nga data 09.05.2021, lidhur me pagesën e borxhit në shumë prej 10.000 euro, në emër të gjobës administrative, me kamatë ligjore 8 %, nga dita e paraqitjes së propozimit me datë 24.05.2021 e deri në pagesën definitive.

III. Secila palë i bartë shpenzimet e përmbarimit në këtë çështje juridike të përmbarimit përveç se deri në përfundimin e procedurës në këtë çështje juridike të përmbarimit, të gjitha shpenzimet e përmbarimit, do t'i bartë ajo palë e cila e humb procesin gjyqësor – përmbarimor.

**A r s y e t i m**

Organi i përmbarimit, përmbaruesi privat I.I.K në Prishtinë, ka caktuar përmbarimin sipas Urdhrin për përmbarim P.nr.212/21, i datës 24.05.2021, në bazë të dokumentit përmbarimor

aktvendimit të Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale, Nr.2718, i datës 04.10.2012, i formës së prerë nga data 23.04.2021, i ekzekutueshme nga data 09.05.2021 dhe aktvendimit të Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale, Nr.2719, i datës 04.10.2012, i formës së prerë nga data 23.04.2021, ti ekzekutueshme nga data 09.05.2021, lidhur me pagesën e borxhit në shumë prej 10.000 euro, në emër të gjobës administrative, të caktuar sipas aktvendimeve të lartpërmendura.

Kundër urdhrin me të cilin është caktuar përmbarimi, debitori brenda afatit ligjor ka paraqitur prapësim me të cilin e ka kontestuar urdhrin për lejimin e përmbarimit, me pretendime se aktvendimet të cilët i janë bashkangjitur propozimit të përmbarim nuk i janë dorëzuar personalisht debitorit, si dhe faktikisht nuk janë të plotfuqishme, andaj urdhri për përmbarim përmban shkelje esenciale procedurale dhe si i tillë është i ligjërishëm i paqëndrueshëm. Duke shtuar se përveç shkeljeve procedurale në rastin konkret kemi të bëjmë edhe parashkrimin e kërkesës së kreditorit, për shkak se me dispozitën e nenit 352, të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve shprehimisht është përcaktuar se afati i përgjithshëm i parashkrimit të kërkesave është 5 vjet. I njëjti ka theksuar se aktvendimet e kreditorit me të cilat janë shqiptuar gjobat janë marrë me datë 04.10.2012, ndërsa propozimi për përmbarim është ushtruar me datë 20.05.2021 nga çka rezulton se kanë kaluar mbi 9 vite, andaj rezulton se kemi të bëjmë me parashkrim të pagesës së gjobave. Gjykatës i propozoi që ta hedhë poshtë, si të pa lejuar urdhërin për lejimin e përmbarimit si dhe ta pezulloj procedurën përmbarimore për shkak të parashkrimit të kërkesës. Shpenzimet e procedurës nuk i ka kërkuar.

Kreditori ka paraqitur përgjigje në prapësim me datë 17.01.2023, duke cekur se i kundërshton pretendimet e debitorëve në tërësi si të pabazuara. Duke shtuar se prapësimi i debitorit nuk përmbana kurrfarë arsytimi të bazuar në fakte dhe prova të cilat janë paraparë në nenin 71 të LPP-së. Pretendimi debitorit se asnjëherë nuk i është dorëzuar personalisht aktvendimet të cilat i janë bashkangjitur propozimit për përmbarim është pretendim i pabazuar dhe nuk është i mbështetshme në prova për faktin se debitori përkatësisht familjarët e tij me datën 23.03.2021, i kanë pranuar aktvendimet me njoftimin sipas Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative. I njëjti ka theksuar se duke pasur parasysh faktin se debitori me datën 23.03.2021, i ka pranuar të dy aktet administrative, si dhe lidhur me këtë çështje i njëjti nuk ka ushtruar ankesë në Komisionin e Ankesave të KPMM-së, si organ i shkallës së dytë, vendimi i dhënë në procedurën administrative në pajtim me nenin 24 par. 3 të Ligjit për Procedurën Përmbarimore është i përmbarueshëm. Duke shtuar se pretendimi i debitorit se në rastin konkret në bazë të nenit 352 të LMD-së ka kaluar afati 5 vjeçar i parashkrimit, ngase nga nxjerrja e vendimit deri te parashkrimi i propozimit për përmbarim kanë kaluar mbi 9 vite, është pretendime i pabazuar, për faktin se sipas dispozitës së nenit 361 të LMD-së, parashihet se të gjitha kërkesat që janë vërtetuar me vendim të formës së prerë të gjykatës ose me vendim tjetër të organit tjetër kompetent, ose me ujdinë e palëve para gjykatës apo organit tjetër kompetent parashkruhen për dhjetë (10) vjet madje edhe për ato për të cilat ligji parashikon afat më të shkurtër të parashkrimit.

Gjykatës i ka propozuar që prapësimin e debitorit ta refuzoj si të pa bazuar. Shpenzimet e përmbarimor i ka kërkuar.

Gjykata pas shqyrtimit të propozimit të kreditores, urdhrat për caktimin e përmbarimit, prapësimit të debitorit, përgjigjes në prapësim, si dhe shkresave tjera të lëndës ka ardhur në përfundim se prapësimi i debitorit është në tërësi i pabazuar.

Gjykata me analizimin e propozimit për përmbarim P.nr.212/21 të datës 24.05.2021, Aktvendimit Nr.2718, i datës 04.10.2012 dhe Aktvendimit Nr.2719, i datës 04.10.2012 të dhënë në procedurën administrative nga KPMM-ja, ka ardhur në përfundim se debitori në bazë të këtyre aktvendimit ndaj kreditores ka krijuar borxh shumë prej 10.000 Euro, të njëjtat aktvendime sipas të cilëve është parashtruar propozimi për përmbarim kanë marrë formën e prerë me datë 23.04.2021, ndërsa janë bërë të ekzekutueshëm nga data 09.05.2021 dhe se i përmbushin të gjitha kushtet ligjore konform LPP-së nenit 22 par.1 nënpar.1.2, nenit 23 par.2 dhe nenit 24 par.3 në të cilët përcaktohet se (neni 22 par.1 nënpar.1.2) *”Dokumente përmbaruese janë: 1.2. vendimi përmbarues i dhënë në procedurë administrative...”*, neni 23 par.2 *”Vendim i organit administrativ, sipas këtij ligji konsiderohet vendimi dhe konkluzioni i dhënë në procedurë administrative nga organi ose shërbimi administrativ apo nga personi juridik i ngarkuar me autorizime publike”* dhe neni 24 par. 3 *”Vendimi i dhënë në procedurë administrative është përmbarimor, po qe se i tillë është bërë sipas rregullave me të cilat është rregulluar procedura e tillë”*.

Sipas LPP-së nenit 27 par.1 përcaktohet se *”Dokumenti përmbarimor është i përshtatshëm për përmbarim në qoftë se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, mjetet, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit”*. Nga kjo rezulton se vendimet në fjalë janë titull përmbarimor për shkak se e kanë të përcaktuar kreditorin dhe debitorin, kohën e përmbushjes së detyrimit, dhe shumën e përmbushjes. Për këto arsye gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Pretendimet e debitorit se aktvendimet të cilët i janë bashkangjitur propozimit për përmbarim nuk i janë dorëzuar personalisht nuk qëndrojnë, pasi që nga fletëkthesa e cila i është bashkangjitur shkresave të lëndës vërtetohet fati se Aktvendimi i kreditorit Nr.2718, i datës 04.10.2012 dhe Aktvendimi i kreditorit Nr.2719, i datës 04.10.201, nga ana e debitorit janë pranuar me datën 02.03.2021.

Po ashtu pretendimet e debitorit se në rastin konkret kemi parashkrim të kërkesës lidhur me pagesën e gjobës administrative, gjykata i vlerëson si pretendime të pa bazuara. Sipas nenit 379 të LMD-së, i cili ka qenë në fuqi deri më datën 20.12.2012 përcaktohet *“Të gjitha kërkesat që janë përcaktuar me vendim gjyqësor të formës së prerë ose me vendim tjetër të organit kompetent, ose me anë të pajtimit gjyqësor ose organit tjetër kompetent, parashkruhen për dhjetë vjet, edhe për ato për të cilat ligji po ashtu parashikon afat më të shkurtër të parashkrim”*, ndërsa në nenit 388 par. 1 të po këtij ligji përcaktohet *“Parashkrimi ndërprehet me ngritjen e padisë dhe me çdo veprim tjetër të kreditorit të ndërmarr kundër debitorit para gjykatës ose organit tjetër kompetent me qëllim përcaktimin, sigurimin ose realizimin e kërkesës”*. Në këtë procedurë përmbarimore është vërtetuar fakti se nga data 23.04.2021 kur aktvendimet sipas të cilave është parashtruar propozimi për përmbarim kanë marrë formën e prerë, deri në datën 24.05.2021 kur është parashtrua propozimi për përmbarim ka kaluar 1 muaj. Sipas vlerësimit të gjykatës në rastin konkret nuk kemi të bëjmë me parashkrim për shkak se përmbarimi është lejuar më bazë të dokumenteve përmbarimore: aktvendimeve të

Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale, Nr.2718 dhe Nr.2719, të datës 04.10.2012, të cilët kanë marr formën e prerë nga data 23.04.2021, ndërsa janë të ekzekutueshëm nga data 09.05.2021, andaj nga data kur aktvendimet kanë marr formën e prerë, e deri në paraqitjen e propozimit për përmbarrim nuk kanë kaluar më shumë se 10 vite. Përveç kësaj pretendimi i debitorit lidhur me parashkrim, me arsyetim se nga nxjerrja e vendimit deri te parashkrimi i propozimit për përmbarrim kanë kaluar mbi 9 vite, po ashtu për gjykatë është pretendime i pabazuar, pasi që sipas dispozitave ligjore afati i parashkrimit fillon të rrjell nga dita kur vendim merr formën e prerë, dhe jo nga data e nxjerrjes së vendimit siç pretendon debitori. Po ashtu në rastin konkret nuk ka kaluar as afati i parashkrimit 5 vjeçar, i përcaktuar sipas nenit 352 të LMD-së, i cili afat pretendon debitori se duhet të zbatohet.

Gjykata vendosi lidhur me kamatën ligjore si në dispozitiv të këtij aktvendimi konform nenit 382 të LMD-së.

Vendimin për shpenzimet e procedurës së përmbarrimit, në këtë çështje juridike të përmbarrimit, kjo gjykatë e mori në kuptim të nenit 13 të LPP-së lidhur me nenin 452 par.1 të LPK-së, pasi që secila palë duhet t'i bartë paraprakisht harxhimet të cilat i ka shkaktuar me veprimet procedurale të veta përveç se deri në përfundimin e procedurës në këtë çështje juridike të përmbarrimit, të gjitha shpenzimet e përmbarrimit do t'i bartë ajo palë e cila e humb procesin gjyqësor – përmbarrimor.

Nga ajo që u tha më lartë, duke u mbështetur në dispozitat e nenit 22 par.1 nënpar.1.2, neni 23 par.2, 24 par.1, neni 27 par.1, neni 71,73 neni 77 par.1, të Ligjit për Procedurën Përmbarrimore, si dhe nenit 382 par.1 të LMD-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA NË RAHOVEC  
PPP.nr.105/2021, me datë 03.06.2024

Bashkëpunëtorja profesionale  
Adelina Çmega

Gjyqtari  
Betim Behluli

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa në afat prej 7 (shtatë) ditëve, nga dita e pranimit. Ankesa ushtrohet përmes kësaj gjykate, për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.